REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 3875/Prot.

Pogradec, më 28.10.2026

VENDIM

NR. 125, DATË 27.10.2026

MIRATIMI I PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË DATËS 12.10.2026 TË KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC

Këshilli I Bashkisë Pogradec në mbledhjen e tij të datës së sotme,pasi lexoi proces-verbalin e zbardhur nga Sekretarja e Këshillit të mbledhjes së datës 12.10 .2026, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, pika 8 dhe neni 54, gërma k si dhe neni 92 e Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec miratuar me VKB nr 40, datë 05.03.2020.

KËSHILLI I BASHKIAK

VENDOSI:

1. Të miratojë proces verbalin e mbledhjes të Këshillit të Bashkisë Pogradec , të datës 12.10.2026 bashkangjitur.
2. Kopja e proces verbalit të miratuar administrohet nga Sekretarja e Këshillit sipas procedurave ligjore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI

1.Miratuar me 27 vota
2.Vota Pro 27
3.Vota Kundër 0
4.Vota Abstenim 0
5.Zbardhur më date 28.10.2026

Mbledhje e Këshillit Bashkiak **Pogradec më 12.10.2026**

ORA : 12:00

JANË PREZENT KËSHILLTARË

PROTOKOLLI I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC DATE 12.10.2026, ME KËTË REND DITE.

RENDI I DITËS

1. **Projekt – Vendim:** Miratimi i Rendit të ditës.
2. **Projekt – Vendim:** Miratimi i Procesverbalit të datës 28.09.2026.
3. **Projekt – Vendim:** Deklarimi I konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimarrjen lidhur me cështjet e rendit të ditës
4. **Projekt – Vendim:** Për një ndryshim në VKB Nr 128 dt 22.12.2025, "Miratimin dhe detajimin e Bashkisë Pogradec për vitin 2026"
5. **Projekt – Vendim:** Miratimin në parim të marrjes me qira sipërfaqe toke/ truall + ndërtesë , për qëllime magazinimi dhe shërbimi, për nevoja të ndërrmarjes së parqeve dhe rekreacionit pranë Bashkisë Pogradec.

Mbledhje e Këshillit Bashkiak **Pogradec më 12.10.2026**

1.Projekt – Vendim: Miratimi i Rendit të ditës.

Znj. Kamolli (Kryetare e Këshillit): Përshëndetje! Jemi mbledhur për zhvillimin e mbledhjes jashte radhe. Materialet ju janë vënë në dispozicion si në mënyrë elektronike, ashtu edhe në formë shkresore.

Kemi një projekt-vendim shtesë te cilin e prezantuam në mbledhjen e komisjoneve.

1.Miratimin në parim për dhënie me qera të pasuris me destinacion "terren sportivë"nr.pasurie 2/375 zona kadastrale8581,me përshkrimin 'Moli I Garave".

Është një projekt –vendim që kalon për konsultim public .Para se të fillojmë doja tju thoja dicka për fjongot rozë të cilat kemi vendosur.Këto fjongo janë për tu solidarizuar me femrat të cilat përballen cdo ditë me kancerin e gjirit.Vec të tjerave këto fjongo janë një thirrje për kujdes dhe mos neglizhence.

Ju lutem, të bëhet prezenca.

Znj. Bojko: Prezente janë 23këshilltarë. Mbledhja deklarohet e hapur.

Znj. Kamolli: Vazhdojmë me rendin e ditës,po e lexoj dhe e hedhim në votim.

U votua

Pro 22

Kundër 1 Z.A.MALE

Abstenim 0 **Miratohet** **PO** JO

Mbledhje e Këshillit Bashkiak **Pogradec më 12.10.2026**

2-Projekt – Vendim :Miratimi i Procesverbalit të datës 28.09.2026.

Znj. Kamolli: Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës. Kush është dakord, e hedhim në votim.

U votua

Pro 22

Kundër 1 Z. MALE

Abstenim 0 **Miratohet** **Po** Jo

Mbledhje e Këshillit Bashkiak **Pogradec më 12.10.2026**

3.Deklarimi I konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimarrjen lidhur me cështjet e rendit të ditës.

Znj. Kamolli: Ju lutem, nëse dikush ka konflikt interesi, le ta deklarojë.

Z.Zhaneta Elezi deklaron që ka konflikt interesi me projekt-vendimin nr .4 ,ndaj përjashtohet nga votimi.

Mbledhje e Këshillit Bashkiak **Pogradec më 12.10.2026**

4.Projekt – Vendim: Për një ndryshim në VKB Nr 128 dt 22.12.2025, "Miratimin dhe detajimin e Bashkisë Pogradec për vitin 2026"

Znj. Kamolli: Vazhdojmë me projekt-vendimin që kemi për ta diskutiar. Dëgjojmë drejtoreshen e financas.

Znj.Karapanca: Muajin e kaluar ne kemi future në këshill një projekt-vendim për ndërtesën e gjeologjisë.Kemi bërë disa ndryshime në projekt dhe si rezultat edhe në buxhet ndaj e kemi risjellë.

Z.Ziko : Me projektin që kemi deri tani nuk është e mundur që të realizohet kanalizimi I godinës ,ndaj kemi shtuar një shtesë në projekt ,kështu që kemi shtuar edhe buxhetin.

Znj.Elezi:E falenderoj kryetarin për investimin e bërë.

Do të zgjidhet problemii I strehimit social si dhe pamja e qytetit do përmirsohet.

Znj. Kamolli:Z.Zhaneta Elezi përjashtohet nga votimi për shkak të konfliktit të interest.

Znj. Kamolli: E hedhim në votim ju lutem koleg

Pro 21

Kundër 1 Z.Gjona

Abstenim 0 **Miratohet Po** Jo

Mbledhje e Këshillit Bashkiak **Pogradec më 28.09.2026**

5.Projekt – Vendim :Miratimin në parim të marrjes me qira sipërfaqe toke/ truall + ndërtesë , për qëllime magazinimi dhe shërbimi, për nevoja të ndërrmarjes së parqeve dhe rekreacionit pranë Bashkisë Pogradec

Znj. Kamolli: Vazhdojmë me shqyrtimin e pikës së pestë të rendit të ditës.

Z.Haxhillari: Ne e kemi diskutuar tashmë disa herë ,mendoj që është e qartë .

Z.Male: Mirë do të ishte të dihej vlera dhe dicka tjetër unë që neser do të kërkoj një kopjë të kontratës së bashkisë më subjektin.Po ashtu nuk e di a lejohet që të futet një projekt-vendim më shumë se dy herë.

Znj.Bojko: Nuk ka asnjë pikë që të përcaktojë në ligj sa herë duhet të futët një vendim në këshill.

Znj.Topa: Kur ishte një rast I ngjashëm në një mbledhje tjeter ne e futem me ndryshim titulli projekt-vendimin,por nuk është problem.

Z.Pikuli:Për znj.Topa kam një pyetje :Po pika nr.2 e këtij projekt-vendimi qëndron?

Këshilli nuk përcakton procedurën .Ato janë rregulla të shtuara ,ndaj unë mëndoj që pika nr.2 të hiqet me gjithë nën pikat e saj.

Znj.Topa: Ke të drejtë.

Znj. Kamolli:

Përvec kësaj mendoj që edhe kontrata të jetë 5-vjecare.

Atëhere e hedhim në votim me të dy ndryshimet e thënë më sipër .

Pra pika nr.2 hiqet e gjitha dhe kontrata nga tri vjeë bëhët pesë.

Znj. Kamolli: Në rregull. Nëse nuk ka diskutime të tjera, e kalojmë për miratim me votim. Ju lutem, kush është dakord?

Pro 19

Kundër 3 Z.Gjona;Z.Male;Z.Mancellari

Abstenim 1 Znj.Prifti **Miratohet** **Po** Jo

Znj. Kryetare: Ju falenderoj per prezencen.Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Protokolloi;Matilda Tollaku

